



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 603 Prot.

Tiranë, më 07 . 04 . 2025

V E N D I M

Nr. 80, datë 07 . 04 . 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, ku përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”, si dhe duke marrë indicien nga transmetimi i emisionit “Inside Story”, më datë 20.11.2024, në kanalin televiziv kombëtar Top Channel², me tematikë: “Skemat e mjerimit”- “Paratë e projekteve sociale shpërdorohen në investime korruptive”, Komisioneri³, me Urdhrin nr. 188, datë 02.12.2024, ka filluar ndjekjen kryesisht të çështjes së mungesës së ofrimit të shërbimeve thelbësore të personave të moshuar që jetojnë vetëm, nisur nga paraqitja e situatës tejet të rëndë dhe kushteve të papërshtatshme të jetesës së znj. M. E. P, një e moshuar 85 vjeçare, e cila jeton e vetme në banesën e shkatërruar nga tërmeti i vitit 2019⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

- I. Parashtrimi i fakteve bazuar në emisionin “Inside Story”, me tematikë: “Skemat e mjerimit”- “Paratë e projekteve sociale shpërdorohen në investime korruptive”, transmetuar më datë 20.11.2024, në kanalin televiziv kombëtar Top Channel.**

¹ Në vijim referuar me shkurtesën LMD.

² <https://youtu.be/tz2qDy7MfDM?si=56GLyËQcBSmHcmct>

³ Referuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe në vijim edhe me akronimin KMD.

⁴ Nisur nga paraqitja e situatës tejet të rëndë dhe kushteve të papërshtatshme të jetesës së znj. M. P, prezantuar në emisionin “Inside Story”, në Tv Top Channel, me tematikë: “Skemat e mjerimit”- “Paratë e projekteve sociale shpërdorohen në investime korruptive”.

Duke marrë indicien nga transmetimi i emisionit “Inside Story”, më datë 20.11.2024, në kanalin televiziv kombëtar Top Channel⁵, me tematikë: “Skemat e mjerimit”- “Paratë e projekteve sociale shpërdorohen në investime korruptive”, lidhur me mungesën e ofrimit të shërbimeve thelbësore të personave të moshuar që jetojnë vetëm, nisur nga paraqitja e situatës tejet të rëndë dhe kushteve të papërshtatshme të jetesës së znj. M. P, një e moshuar 85 vjeçare, e cila jeton e vetme në banesën e shkatërruar nga tërmeti i vitit 2019⁶; si dhe mbështetur në nenin 41/2/a⁷ të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, si dhe në nenin 32, pika 1, shkronjat c), f) dhe pika 2, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar; me Urdhrin nr. 188, datë 02.12.2024, ka filluar ndjekjen kryesisht të çështjes së mungesës së ofrimit të shërbimeve thelbësore të personave të moshuar që jetojnë vetëm.

Referuar informacionit të përcjellë në emisionin sipërcituar, ndër të tjera, evidentohen një sërë problematikash, si:

- Znj. M. E. P, është një e moshuar me moshë 85 vjeç, e cila jeton e vetme pasi nuk ka asnjë të afërm që përkujdeset për të;
- Znj. P jeton në katin e parë të një pallati në lagjen nr. 18, tek pallatet e ish të përndjekurve politikë, Durrës;
- Nga pamjet e transmetuara në kronikën në fjalë, konstatohet se banesa e saj është në kushte të pabanueshme dhe jashtë çdo standardi të një jetese të përshtatshme dhe dinjitoze për një njeri dhe aq më tepër për një të moshuar 85-vjeçare, e cila jeton e vetme, pa përkujdesjen e asnjë personi, familjar, të afërm apo jo;
- Nga kronika evidentohet se pallati është prekur nga dëmtimet e tërmetit të ndodhur në vitin 2019, dhe se të gjitha banesat e tjera janë riparuar nga strukturat përgjegjëse që janë marrë me rindërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019, dhe se, vetëm në banesën e znj. P nuk është ndërhyrë për rindërtimin a riparimin e saj. Nga pamjet, banesa duket e dëmtuar, pa dyer dhe dritare dhe në kushte aspak të përshtatshme për jetesë;
- Në banesë mungon furnizimi me energji elektrike dhe ujë të pijshëm;
- E moshuara, znj. P në intervistën e saj thekson faktin se është e vetme, familjarët e saj kanë vdekur të gjithë dhe se jeton në kushte të mjerueshme, pa ushqim të mjaftueshëm, pa përkujdesje mjekësore, pa ndriçim e ngrohje dhe se në temperaturat e ulëta të dimrit e ka tejet të vështirë jetesën, larg çdo standardi të jetesës normale e dinjitoze për një të moshuar.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri, për shqyrtimin e çështjes.

⁵ <https://youtu.be/tz2qDy7MfDM?si=56GLyEQcBSmHcmct>

⁶ Nisur nga paraqitja e situatës tejet të rëndë dhe kushteve të papërshtatshme të jetesës së znj. P, prezantuar në emisionin “Inside Story”, në Tv Top Channel, me tematikë: “Skemat e mjerimit”- “Paratë e projekteve sociale shpërdorohen në investime korruptive”.

⁷ “Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur:

a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës...”

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në lidhje me pretendimin e paraqitur, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1613/1 prot., datë 04.12.2024, ka kërkuar informacion⁸ nga ana e Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Durrës, Drejtorisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime sh a (DRUK) Durrës dhe Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sha (DROSSH) Durrës.

Nisur nga ndjeshmëria e rastit të znj. P dhe situata tejet kritike në të cilën ajo ndodhet, në kushtet e një mjerimi të skajshëm, ku diskutohet mbijetesa në temperaturat e ulëta të dimrit, *Komisioneri ka kërkuar marrjen e masave urgjente* për largimin e përkohshëm të zonjës së moshuar M. P, në një qendër të përkujdesjes për të moshuarit në qytetin e Durrësit, ku ajo banon, deri në marrjen e masave

⁸ Specifikisht:

- “Informacion dhe parashtrimet tuaja në lidhje me situatën sa më sipër, sipas fushës tuaj të përgjegjësisë dhe kompetencave respektive institucionale.
- Informacion dhe dokumentacion provues, ku të evidentohet se cilat janë masat e ndërmarra lidhur me secilën problematikë të evidentuar më sipër.
- A i është nënshtruar vlerësimit të dëmit të shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019, pallati ku jeton e moshuara? Kopje të aktit të konstatimit nga organi përgjegjës, të dëmeve dhe masave apo nevojave për ndërhyrje, riparime të tij, etj, si dhe kopje të akteve të marrjes në dorëzim, nëse janë bërë ndërhyrjet apo riparimet përkatëse.
- A i është nënshtruar vlerësimit të dëmit të shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019, banesa ku jeton e moshuara, (ndodhur në katin e parë, të pallatit të ish-të përndjekurve politikë, në lagjen nr. 18, Durrës)? Kopje të aktit të konstatimit nga organi përgjegjës, të dëmeve dhe masave apo nevojave për ndërhyrje, riparime të tij, etj, si dhe të akteve të marrjes në dorëzim, nëse janë bërë ndërhyrjet apo riparimet përkatëse.
- A është identifikuar si person në nevojë, e moshuara M. P, si person që jeton e vetme pa përkujdesjen e familjarëve apo të afërme? A është ndihmuar apo asistuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Durrës apo DR SHSSH Durrës? Kopje të akteve provuese apo fakte e rrethana shpjeguese. Nëse po, si është ndihmuar, asistuar konkretisht znj. P, referuar secilës problematikë të evidentuar, nga strukturat tuaja përkatëse.
- Nëse dispononi informacion, prej sa vitesh e moshuara M. P është banore në lagjen nr. 18, tek pallatet e ish të përndjekurve politikë, Durrës?
- A është furnizuar ndër vite me energji elektrike dhe ujë të pijshëm banesa në të cilën jeton znj. M. P? Aktualisht, a vijon të furnizohet banesa e saj me energji elektike apo me ujë të pijshëm. Argumentimin tuaj.
- Nëse jo, me marrjen dijeni të këtij fakti, nisur nga specifika dhe ndjeshmëria e rastit të znj. M. P, konkretisht cilat janë masat që janë ndërmarrë apo do të ndërmerren nga ana juaj respektivisht për furnizimin e banesës së saj me energji elektrike dhe ujë të pijshëm? Parashtrime dhe kopje të akteve shkresore.
- Sa është numri i personave të moshuar që jetojnë të vetëm, pa përkujdesjen e familjarëve apo të afërmeve, në Bashkinë Durrës? Cilat janë masat apo veprimet e ndërmarra nga ana juaj rast pas rasti. A ka një plan veprimi apo masash për këtë kategori personash vulnerabël, nga ana e institucioneve tuaja respektive? Nëse po, një kopje të akteve shkresore.
- Si dhe çdo informacion ose dokumentacion tjetër që mendoni se i shërben sqarimit të çështjes.”

për rregullimin e banesës së saj me kushtet e paramentrat e një banese normale, të përshtatshme për një jetesë dinjitoze dhe në përputhje me standardet e kërkuara.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 13042/2 prot., datë 23.12.2024, OSSH sha, ka informuar Komisionerin se:

“Shoqëria OSSH sha ka kryer verifikimin e rastit të paraqitur nga Komisioneri, duke dërguar grupin e posaçëm të kontrollit në terren në adresën e banimit të znj. P. Nga ky kontroll rezultoi se znj. P furnizohet me kontratën DU0A1300390309973, me titullar A. P.

Është kryer verifikimi i matësit me të cilin furnizohet kjo kontratë, i cili ndodhet në boksen kolektiv të pallatit. Nga ky verifikim ka rezultuar se matësi është brenda kushteve teknike dhe në apartamentin e znj. P nuk ka linjë furnizimi me energji elektrike. Nga sa më sipër sqaruar, problematika e mungesës së furnizimit me energji elektrike vjen si pasojë e gjendejs jofunksionale të rrejtit të brendshëm të apartamentit.

Shoqëria OSSH sha, bazohet në parashikimet e Rregullores së Lidhjeve të Reja në sistemin e shpërndarjes, miratuar me Vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, i cili në pikën 1.11 përcakton detyrimet e shoqërisë shpërndarëse deri në instalimin e sistemit të matjes për objektin e furnizuar.

Gjithashtu nga konsultimi i sistemit të faturimit të energjië elektrike të shoqërisë FSHU sha, rezulton se kontrata e furnizimit të energjisë elektrike ka statusin aktiv.

Nga sa më sipër, me vënien në funksionalitet të rrjetit të brendshëm të banesës së znj. P, do të bëhet furnizimi me energji elektrike i saj.”

Sa më sipër pasqyrohet në procesverbalin e mbajtur me datë 17.12.2024, nga DROSSH sha Durrës, si dhe fotot e bashkëlidhura të banesës së znj. P dhe matësit në boks.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 5893/1 prot., datë 26.12.2024, DRUK sha Durrës sha, ka informuar Komisionerin se:

“Nga verifikimi në terren, në objektin e znj. P rezulton se ka furnizim me ujë. Nga ana e Shoqërisë tonë, duke pasur parasysh situatën në të cilën ndodhet znj. M. P është garantuar furnizimi me ujë”.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 3822 prot., datë 24.12.2024, DRSHSSH Durrës sha, ka informuar Komisionerin se:

“Znj. P, aktualisht 85 vjeçe, e datëlindjes 26.10.1939, ka filluar të marrë shërbim pranë Qendrës Ditorë të Moshuarve në Durrës, më datë 06.12.2010, së bashku me motrën e saj, znj. Zh. P, e cila më pas ndërroi jetë.

Znj. P aktualisht jeton e vetme, herë pas here është informuar për shërbimet që ofrohen për moshën e tretë në Bashkinë Durrës, si dhe për shërbime rezidencialae, që ofrohen jashtë Bashkisë Durrës,

për t'i lehtësuar procesin e mbledhjes së dokumentacionit, në rast se dëshironte shërbimet rezidenciale. Qytetarja nuk ka shprehur interes për këto shërbime.

Që nga muaji dhjetor 2010 e deri në vazhdimësi, znj. M. P ka përfutur të gjitha shërbimet që ofrohen në qendër si shërbimin psiko-social, shërbimin e infermierit dhe mjekut, vaktin ushqimor të përditshëm, duke i dhënë me vete dhe ushqim për vaktin e darkës ose për ditët e pushimit.

Gjithashtu e moshuara shpesh ka përdorur dushin dhe shërbimin e lavanderisë së Qendrës, për të mundësuar higjenën e saj personale. Të moshuarës i është ofruar ndihmë me baza materiale të ndryshme, duke filluar nga ushqimi, veshmbathja, produktet të kujdesit personal, etj.

Në rastet kur e moshuara nuk ka frekuentuar qendrën ditore, për arsye shëndetësore apo gjatë pandemisë, ushqimi i është dërguar në shtëpi nga stafi psiko-socila i Qendrës, por e moshuara nuk i ka lejuar që stafi të futej në banesë. Pas tërmetit të vitit 2019, shtëpia e saj pati dëmtime të shumta dhe për këtë arsye punonjësit e Qendrës i ofruan gjithë mbështetjen për largimin nga banesa, në mënyrë që të bëhej rikonstruksioni i banesës, por zonja nuk pranoi.

Përsa i përket gjendjes së saj psiko-sociale e moshuara paraqet një gjendje të qëndrueshme. Ajo është aktive në Qendër, duke marrë pjesë çdo ditë në aktivitete që zhvillohen në Qendër apo dhe jashtë saj.

Gjendur përballë këtij fakti, DRSHSSH Durrës në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin Social pranë Bashkisë Durrës, do të jenë në monitorim të vazhdueshëm të situatës së znj. P, për të lehtësuar me anë të politikave mbështetëse situatën social-ekonomike të saj.”

2. Në mungesë të dërgimit të informacionit të kërkuar nga ana e Bashkisë Durrës, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 209 prot., datë 29.01.2025, iu drejtua sërish Bashkisë, duke kërkuar të njihet me parashtrimet dhe masat e ndërmarra prej saj, për problematikën emergjente të znj. P.
- Bashkia Durrës, pavarësisht faktit se ka marrë dijeni për shkresën sipërcituar⁹ sërish nuk ka dërguar asnjë informacion për sa i është kërkuar nga KMD.
3. Në vijim të sa më sipër, Komisioneri me Vendimin nr. 41, datë 27.02.2025, ka vendosur, ndër të tjera që: “1. Bashkia Durrës, të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi....4. Dërgimi i informacionit të kërkuar nga Komisioneri, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e Vendimit për sanksionin me gjobë, sjell shfuqizimin e tij.”.

⁹ Bashkia Durrës ka marrë dijeni për shkresën nr. 209 prot., datë 29.01.2025, të Komisionerit, me datë 30.01.2025, fakt ky që rezultoi i provuar nga lajmërimi marrja e shërbimit postar: RR 725 096 383 AA, administruar në dosje

4. Në zbatim të Vendimit sipërcituar, Bashkia Durrës, me shkresën me nr. 1623/1 prot., datë 06.03.2025, ka informuar Komisionerin, duke evidentuar se:

“Përsa i përket vlerësimit të dëmit të shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019, pallati ku jeton e moshuara M. P, përkon me objektin me kod Gis 19063. Objekti, sipas aktit të konstatimit bashkëlidhur është cilësuar me nivel dëmi DS4. Në të njëjtën kohë, nga Instituti i Ndërtimit është lëshuar ekspertiza e thelluar për përforcim objekti DS4.

Znj. P është banore në katin përdhe të pallatit sipërcituar. Ky objekt është trajtuar në Kontratën për Punë Publike “Në kuadër të procesit të rindërtimit”, me objekt “Riforcimi i pallateve me kod Gis 19063, 1053, 19057, riforcimi i banesave individuale në njësinë administrative Rrashbull, të banorëve: H. H, L. R, M. Pi, M. H dhe riforcimi i banesave individuale në rajonin nr. 6, të banorëve: L. O, F. N.

Ju bëjmë me dije se, znj. P që në fillimet e punimeve të riforcimit të godinës është bërë pengesë serioze për lirim të apartamentit. Ju përcjellim edhe një korrespondencë shkresore, pas shqetësimit të përcjellë nga ana e kontraktorit të punimeve, dhe në këto kushte, Bashkia Durrës i ka kërkuar ndihmë edhe Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës për lirim të sheshit të ndërtimit, konkretisht largimin e znj. , me qëllim zbatimin e punimeve. Megjithatë, punimet në total në këtë godinë nuk kanë përfunduar.

Znj. M. P, aktualisht e moshës 85 vjeç, jeton e vetme, me të ardhura vetëm nga pensioni i pleqërisë. Kjo e moshuar ka filluar të marrë shërbim pranë Qendrës Ditore të Moshuarve në Durrës, me datë 06.12.2010, së bashku me motrën e saj, znj. Zh. P, e cila më pas ka ndërruar jetë.

Qendra Ditore e të Moshuarve Durrës, është një qendër që financohet nga Bashkia Durrës, dhe të moshuarës M. P, që nga muaji dhjetor 2010, i ofrohen të gjitha shërbimet që ofron kjo qendër si: shërbimin psiko-social, shërbimin e infermiert dhe mjekut, vaktin ushqimor të përditshëm, duke i dhënë me vete dhe ushqim për vaktin e darkës ose për ditët e pushimit.

Gjithashtu e moshuara shpesh ka përdorur dushin dhe shërbimin e lavanderisë së Qendrës, për të mundur higjenën e saj personale. Të moshuarës i është ofruar ndihmë me baza materiale të ndryshme, duke filluar nga ushqimi, veshmbathja, produktet e kujdesit personal, etj.

Në rastet kur e moshuara nuk ka frekuentuar qendrën ditore, për arsye shëndetësore apo gjatë pandemisë, ushqimi i është dërguar në shtëpi nga stafi psiko-social i Qendrës, por e moshuara nuk ka lejuar që stafi të futej në banesë. Pas tërmetit të vitit 2019, shtëpia e saj pati dëmtime të shumta dhe për këtë arsye punonjësit e Qendrës i ofruan gjithë mbështetjen për largimin nga banesa, në mënyrë që të bëjë rikonstruksionin e banesës, por zonja nuk pranoi.

Përsa i përket gjendjes së saj psiko-sociale e moshuara paraqet një gjendje të qëndrueshme. Ajo është aktive në Qendër, duke marrë pjesë çdo ditë në aktivitete që zhvillohen në Qendër apo dhe jashtë saj. E moshuara në përditshëmrinë e saj shoqërohet dhe suportohet edhe nga një i moshuar z. Sh. Ki, i cili merr gjithashtu shërbime në të njëjtën qendër ditore. Stafi i Qendrës të moshuarën e ka trajtuar në mënyrë të veçantë me përkujdes të shtuar.

Në Bashkinë Durrës, bazuar në kërkesat e të moshuarve, referimet e ndryshme nga vizitat në familje, rezulton se janë rreth 230 të moshuar, që jetojnë vetëm, pa përkujdesin e familjarëve apo të afërmeve.

Rastet e të moshuarve që janë identifikuar apo referuar në Bashki, pasi janë bërë vlerësimet e nevojave të tyre nga punonjësit socialë, u janë ofruar shërbime të ndryshme sipas nevojave të çdo rasti, duke u mbështetur në shërbime si: ndihmë ekonomike, paketa ushqimore, shërbime shëndetësore, shërbime në familje, sistemim në azile si dhe përfshirjen në shërbimet e Qendrës Ditore të Moshuarve Durrës. Aktualisht në Qendër marrin shërbim 110 të moshuar.

Bashkia Durrës ka pasur prioritet shërbimet për moshën e tretë, sipas Planit Social 2021-2024, të miratuar në Këshillin Bashkiak Durrës me Vendimin nr. 161, datë 23.12.2021, ku në Objektivin nr. 2.3, ka parashikuar ofrimin e shërbimeve alternative për moshën e tretë, të cilat janë ofruar në familje rast pas rasti.

Edhe në Planin e Ri Social, i cili është në proces hartimi, Bashkia Durrës do të synojë përmirësimin e shërbimeve ekzistuese për moshën e tretë, përmes ngritjes së shërbimeve të kujdesit në shtëpi (ofruar nga një skuadër psiko-sociale), në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse që operojnë në këtë fushë, duke siguruar mbulimin e nevojave të të moshuarve të vetmuar, me vështirësi në lëvizje, apo që banojnë në zona larg shërbimit, duke bashkëpunuar ngushtësisht edhe me NJVKSH Durrës.

Ndërkohë, sipas informacionit të Njesisë Administrative nr. 4 Durrës, bazuar në të dhënat e Zyrës së Gjendjes Civile, qytetarja M. P rezulton të jetë banore e Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, por pavarësisht këtij fakti, është konstatuar se ajo që prej viti 2002 është rezidente në lagjen nr. 18, ndërtesa 18, hyrja 4, apartamenti 1, Durrës.”

- Pas administrimit të informacionit sipërcituar, dëguar nga ana e Bashkisë Durrës, Komisioneri, me Vendimin nr. 55, datë 12.03.2025, ka vendosur shfuqizimin e vendimit me gjobë (Vendimit nr. 41, datë 27.02.2025, të KMD-së) dhe vazhdimin e procedurës së shqyrtimit kryesisht të çështjes në fjalë, të iniciuar kryesisht nga KMD.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm

Mështetur në provat e administruara, si rezultat i fatkeqësisë natyrore, tërmeti që goditi Shqipërinë në datë 26 Nëntor 2019, dëmtoi edhe ndërtesën në të cilën banon e moshuara e vetmuar, znj. P (pallati me kod Gis 19063).

Për shkak të fatkeqësisë natyrore, si shkak i tërmetit që preku Shqipërinë në datë 26 Nëntor 2019, Këshilli i Ministrave miratoi Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”, i cili në Nenin 5 ka përcaktuar subjektet përfituese.

Kështu në pikën 1 të nenit 5 përcaktohet se: *“Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore”.*

Në nenin 18, pika 7 të VKM-së së sipërcituar është parashikuar se:

“7. Kushtet, kriteret, kategoritë prioritare, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, përfshirë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfituesit nuk mund të përfitojnë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit për qëllime strehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë akt. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që subjektet të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Subjektet përfituese nga programet e procesit të rindërtimit konsiderohen që shpërblehen, jo më shumë se vlera e dëmit real të përbërë nga humbja e pësuar e jetës së njeriut dhe/ose vlera e dëmeve pasurore”.

Në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, janë përcaktuar në mënyrë të qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe lokale për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyror. Referuar nenit 13, të këtij Akti Normativ, Këshilli i Ministrave miraton:

a) politikat për përballimin dhe rregullimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

b) propozimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit përpërdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për qëllimet dhe sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë akt normativ;

ii. programin e përgjithshëm të rindërtimit;

iii. përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit;

iv. shpalljen e zonave të reja për zhvillim në përputhje me parashikimet e këtij akti.

c) kushtet, kriteret, fondin financiar dhe rregullat për përdorimin e tij, organet përgjegjëse dhe procedurat për përballimin e pasojave të veçanta të fatkeqësisë natyrore;

ç) shpenzimet operative dhe koordinuese për mirëfunksionimin e fondit të rindërtimit;

d) çdo vendim në lidhje me çështje të tjera në funksion të zbatimit të këtij akti normativ.

- Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, referuar në nenin 14, përbëhet nga 9 ministra, aty merren vendime të cilat i propozohen Këshillit të Ministrave për të detajuar procesin qoftë financiar, qoftë administrativ apo ndërtues, rindërtues në terren.

- Ministria e Rindërtimit në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Ministrave, ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit, shpërndarjen e fondeve për realizimin e këtyre programeve, evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, drejtimin operacional të strukturave dhe të njësive të veçanta, ndjekjen e zbatimit të përgjegjësisë dhe të detyrave të ngarkuara për to etj.

- Instituti i Ndërtimit ka objekt kryesor kryerjen e veprimtarisë kërkimore, shkencore, zhvillimore, projektuese në fushën e ndërtimit, si dhe në procesin e rindërtimit detyra kryesore e tij ishte ekspertiza e thelluar dhe oponenca për vlerësimet e konformitetit dhe kontrollat për produktet e ndërtimit që lidhen me sigurinë e jetës.

- Njësitë e qeverisjes vendore në këtë fatkeqësi natyrore kanë detyrimet të përcaktuara në Aktin Normativ nr. 9 datë 06.12.2019. Këshilli bashkiak në procesin e rindërtimit duhet të:

Administrojë fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave, të miratojë planet e detyruara dhe të detajuara vendore, lejet e zhvillimit e të ndërtimit, të krijojë, administrojë dhe përditësojë bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe të plotësojë nevojat e tyre nga programet e procesit të rindërtimit. Bashkia përmes përfaqësuesve në Njësitë Administrative kryen inspektimin viziv të dëmeve, ngre dhe monitoron grupet e punës për vlerësimin e të gjithë dëmeve, nga Niveli DS1 deri në DS5.

Akti Normativ Nr. 8, datë 7.12.2019 *“Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, parashikon ndër të tjera se:*

Neni 1

Familjeve, të cilave u është dëmtuar banesa si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, dhe janë evakuuar nga banesat e tyre për shkak se u rrezikohet jeta dhe shëndeti, u subvencionohet në masë të plotë pagesa e qirasë së banesës, në vlerën mesatare të tregut të lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe/ose njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 2

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, ngarkohen:

- të hartojnë listat e familjeve, banesat e të cilave janë shembur ose janë klasifikuar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit;

- të vlerësojnë nivelin mesatar të qirasë për struktura të ndryshme apartamentesh, brenda 5 ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ;

- të miratojnë, në këshillin e njësive të vetëqeverisjes vendore, listën e familjeve përfituese;

- të dërgojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën për mbështetje buxhetore për financimin ose bashkëfinancimin e subvencionit, në mënyrë elektronike dhe shkresore, së bashku me informacionin për numrin e familjeve të ngelura të pastreha, sipas klasifikimit të bërë nga Instituti i Ndërtimit.

Neni 3

1. Për përfitimin e subvencionit të pagesës së qirasë, sipas këtij akti normativ, familjet aplikojnë pranë njësive të vetëqeverisjes ku kanë vendbanimin e tyre, duke dorëzuar dokumentacionin, si më

poshtë vijon:

- a) Formularin e aplikimit, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi;*
- b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit;*
- c) Certifikatën familjare;*
- ç) Numrin e llogarisë bankare ku do të derdhet pagesa e qirasë.*

2. Struktura përgjegjëse, e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me strukturat e tjera, përgatisin menjëherë projektvendimin për miratim nga këshilli bashkiak.

Neni 4

Nëse një familje, e cila është e regjistruar në një njësi të vetëqeverisjes vendore, për arsye personale, kërkon të gjejë banesë për strehim në një njësi tjetër të vetëqeverisjes vendore, atëherë përfiton subvencionimin e qirasë në vlerë të barabartë me atë të njësisë ku ndodhet banesa e dëmtuar. Ndërsa, kur gjetja e një banese për strehim në njësinë ku ndodhet banesa e dëmtuar është e pamundur, konfirmuar nga organi i kësaj njësie, atëherë përfiton subvencionimin e qirasë në vlerë të barabartë me atë të njësisë ku është strehuar.”

Neni 26, i Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, “Pagesa e qirasë”, parashikon ndër të tjera se: “

1. Familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, të mbetura të pastreha pasi banesat ose shtëpitë e banimit individuale të tyre janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm, përfitojnë një pagesë qiraje në vlerën mesatare të tregut të lirë, për një vit, që miratohet me vendim të organeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Për përfitimin e pagesës së qirasë, subjektet përfituese aplikojnë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin, duke dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Formularin e aplikimit sipas formati të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore;*
- b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit;*
- c) Certifikatën familjare;*
- ç) Numrin e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë.*

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimin përkatës të subjekteve përfituese dhe të nivelit të qirasë me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

4. Pagesa e qirasë, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të miratohet deri në përfitimin e banesës së re nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose deri në përfundimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të banesës, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit të parashikuara në këtë ligj, nëse përfituesi plotëson kriteret dhe dokumentacionin përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për strehimin social.

5. Shpenzimet e qirasë përballohen nga fondi i rindërtimit, si dhe nga të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

6. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të miratojë qiranë e banesës, sipas parashikimeve të këtij neni, dhe për familje që nuk janë banorë të territorit të vet por që rezultojnë subjekte përfituese në territorin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, bazuar mbi një kërkesë të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, në kushtet e mungesës së mundësive për strehim në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi”.

Në nenin 1 dhe 2 të VKM Nr. 26, datë 15.1.2020 *“Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”*, parashikohet ndër të tjera se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore do të kryejnë aktekspertizë të thelluar për të gjitha objektet për të cilat kërkohet një rivlerësim më i thelluar, mbështetur në aktkonstatimet ose aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit. 2. Aktekspertiza e thelluar i vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës. Instituti i Ndërtimit jep opinionin e tij, i cili mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.”*.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, rezultoi se, znj. M. P, aktualisht e moshës 85 vjeç, jeton e vetme, me të ardhura vetëm nga pensioni i pleqërisë. Që prej vitit 2002 është rezidente në qytetin e Durrësit dhe banon në lagjen 18, rruga “Horizonti”, Ndërtesa 18, Hyrja 4, në katin e 1-të, në një pallati ndërtuar nga Enti i Banesave.

Nisur nga deklaratimet e palëve të përfshira në këtë proces administrativ, rezulton se, që prej dhjetorit të vitit 2010, znj. P ka qenë përfituese e shërbimeve sociale, si nga strukturat e Bashkisë Durrës, ashtu dhe nga ato të DRSHSSH Durrës, bashkë me motrën e saj znj. Zh. P, deri në momentin kur kjo e fundit ka ndërruar jetë. Znj. M. P vijon aktualisht të jetë përfituese e shërbimeve sociale të ofruara nga subjektet sipërcituar, në qytetin e Durrësit.

Në muajin shtator 2019, qyteti i Durrësit u godit nga një tërmet i fuqishëm, i cili shkaktoi humbje jetësh njerëzore si dhe dëme të konsiderueshme në shumë banesa e objekte të ndryshme ndërtimore, konstatuara nga organet kompetente, përfshirë edhe ndërtesën/pallatin ku jeton e moshuara e vetmuar, znj. M. P.

Përsa i përket vlerësimit të dëmit të shkaktuar nga tërmeti i shtatorit të 2019-ës, të pallatit ku jeton znj. P, Komisioneri i referohet vlerësimit të ekspertizës së kryer nga ekspertët e Institutit të Ndërtimit (ID), me nr. 832 prot., datë 14.04.2020, ekspertizë e cila, bazohet në VKM nr. 26/2020 *“Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”* dhe të ligjit nr. 97/2019 *“Për miratimin e aktit normative, me fuqinë e ligjit, nr. 9/2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqsisë natyrore”*.

Sipas akt-ekspertizës së mësipërme, pallati ku jeton e moshuara e vetmuar, znj. P, përkon me objektin me kod Gis 19063. Bazuar në akt-ekspertizën e grupit të punës së ID-së, objekti në fjalë është cilësuar me nivel dëmi DS4 - Dëmtim i rëndë, ku cilësohen specifikimet: *“çarje të mëdha në elementët strukturorë”, “dëmtim të lidhjes së shufrave të përforcuar metra”, “anim i kolonave”, “shkatërrim i disa kolonave ose i një kati i vetëm i sipërm”, si dhe “të tjera”*)

Në shënimin e bërë nga grupi i punës që ka inspektuar pallatin/objektin në fjalë, në rubrikën - Përtej dëmit të identifikuar, a ka ndnjë riparim thelbësor/urgjent për ndërtesën për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm në të ardhmen? – është specifikuar si më poshtë vijon: *“Kati i I-rë i pallatit është i*

pabanuar, ka nevojë urgjente për riparim dhe ka një plasaritje të kolonës në krahun e majtë të godinës”.

Znj. P është banore në katin përdhe të pallatit sipërcituar. Sipas deklarimeve dhe akteve të depozituara nga Bashkia Durrës, rezulton se, ky objekt/pallati ku jeton e moshuara e vetmuar, është trajtuar në Kontratën për Punë Publike “*Në kuadër të procesit të rindërtimit*”, me objekt: “*Riforcimi i pallateve me kod Gis 19063, 19053, 19057. Riforcimi i banesave individuale në....*”

Nga aktet shkresore të shqyrtuara rezulton se, punimet në objektet sipërcituar, përfshirë edhe pallatin ku jeton e banon e moshuara e vetmuar, janë marrë përsipër të kryhen nga subjekti privat, sipërmarrësi “Braka Construction” shpk, sipas Kontratës së datës 14.02.2022, me investitor Bashkinë Durrës.

Nëpërmjet shkresës me nr. 77 prot., datë 08.06.2022, sipërmarrësi “Braka Construction” shpk, i është drejtuar Bashkisë Durrës (investitorit), duke e informuar si vijon:

“Kemi filluar punimet në objektin “Riforcimi i pallateve me kod Gis 19063, 1053, 19057, riforcimi i banesave individuale në njësinë administrative Rrashbull, të banorëve: XXXXXX dhe riforcimi i banesave individuale në rajonin nr. 6, të banorëve: XXXXX.”

Në kuadër të riforcimit të pallatit me kod Gis 19063, na paraqitet një problematikë e tillë ku, në katin përdhe të këtij pallati jeton znj. P, shumë e moshuar, që nuk pranon të dalë nga apartamenti i saj, me justifikimin se nuk ka ku të shkojë. Dhe pas komunikimeve të vazhdueshme me zonjën, ajo pranon në asnjë moment të dalë nga banesa e saj.

Kërkojmë nga institucioni juaj të merren masat e nevojshme për zgjidhjen e situatës së krijuar, pasi znj. P duhet të dalë patjetër nga banesa e saj që të rifillojmë punimet për riforcimin e pallatit me kod Gis 19063”.

Nëpërmjet shkresës me nr. 5210/1 prot., datë 20.06.2022, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, Bashkia Durrës i bën me dije, problematikën e përcjellë nga sipërmarrësi i punimeve të pallatit ku jeton e moshuara e vetmuar, duke theksuar ndër të tjera se: “*Kati përdhe i kësaj godine do të rikonstruktohet totalisht dhe për shkallën e dëmtimit që ka ky objekt, të gjithë banorët janë larguar nga godina, përveç banores znj. P. Ndodhur në kushtet e mësipërme ju kërkojmë ju, Policisë së Rendit, ndihmë për largimin e qytetares nga ambientet e këtij pallati, pasi po bëhet problem serioz për mbarimin e punimeve në afatin e duhur.*”

Nga ana e Bashkisë Durrës është deklaruar se, pas tërmetit të vitit 2019, shtëpia e znj. P pati dëmtime të shumta dhe për këtë arsye punonjësit e Qendrës Ditore të të Moshuarve Durrës, (një qendër e cila financohet nga Bashkia Durrës), i ofruan gjithë mbështetjen për largimin nga banesa, në mënyrë që të bëhej rikonstruksioni i banesës, por zonja nuk pranoi.

Lidhur me situatën e të moshuarës së vetmuar znj. P, e cila jeton e vetme në banesën e saj të dëmtuar rëndë nga tërmeti i shtatorit të vitit 2019, (sipas akt-konstatimeve të ekspertëve të fushës, sipërcituar), Komisioneri konstaton se:

Nga ana e Bashkisë deklarimet lidhur me mbështetjen e ofruar për largimin e znj. P nga banesa, me qëllim sistemimin diku tjetër, deri në rikonstruksionin e banesës së saj, mbeten thjesht të karakterit deklarativ dhe të pashoqëruara e dokumentuara me akte a prova shkresore.

Që nga viti 2019 e deri më sot (mbi 5 vite), Bashkia Durrës ka neglizhuar në ekstrem marrjen e masave të menjëhershme, lidhur me zgjidhjen e problematikës jetike të strehimit të së moshuarës, e cila jeton e vetme, duke mos bërë zhvendosjen e saj nga banesa e dëmtuar nga tërmeti, në një banesë tjetër të përkohshme, deri në përfundimin e punimeve në banesën e dëmtuar rëndë. Bashkia nuk ka dëshmuar me fakte e prova konkrete se ka marrë masa për zgjidhjen e problemit të strehimit të përkohshëm të znj. P.

Pretendimet e Bashkisë se e moshuara, znj. P nuk ka dëshiruar apo pranuar të largohet nga banesa (*e ndodhur në katin përdhe, katin e I-rë të pallatit të dëmtuar rëndë*) e kësaj vazhdon ende të jetojë aty, në kushtë të mjerueshme, në një banesë të pabanueshme (*sipas konstatimeve të ekspertëve të fushës*) pa energji elektrike (pa ndriçim e ngrohje) për mbi 5 vite, janë justifikime për të shmangur përgjegjësinë ligjore të Bashkisë në përkujdesjen e veçantë ndaj kategorisë të moshuarve të vetmuar, e konkretisht rastit të znj. P, veçanërisht ndodhur përballë një fatkeqësie natyrore, si tërmeti shkatërrimtar i vitit 2019.

Po ashtu, pretendimi tjetër i Bashkisë, se nëpërmjet shkresës së datës 20.06.2022, i ka kërkuar ndihmë Policisë së Rendit, për largimin e qytetares znj. P nga ambientet e pallatit ku jeton, pasi po bëhej problem serioz për përfundimin e punimeve në afatin e caktuar, është dhe mbetet thjesht *formal*.

Për shkak të shkallës së rëndë të dëmtimit, sikurse citohet se të gjithë banorët e tjerë janë larguar nga godina, ashtu duhet të ishte larguar edhe znj. P, e moshuara e vetmuar, pavarësisht vullnetit të saj.

Lënia e saj në banesë, e cila është pjesë e punimeve që po kryhen në kuadër të procesit të rindërtimit, për rforcimin e palltit me kod Gis 19063, përveç të tjerave, e ka ekspozuar të moshuarën znj. P, në rrezik të lartë, real e të drejtëpërdrejtë për jetën.

Bashkia Durrës ka pasur të gjithë instrumentat ligjorë, që përmes akteve përkatëse, të detyrueshme për zbatim, të evakuonte e të strehonte të moshuarën në një ambient tjetër, deri në përfundimin e riparimit të banesës së saj.

Pra, nuk rezulton që Bashkia të ketë marrë një vendim qoftë individual për të moshuarën e vetmuar, znj. P, për lirim të banesës për efekt punimesh. Dhe, natyrisht nëse ky vendim do të ishte marrë, do të ishte ekzekutuar në vijim nga Policia e Shtetit, konform ligjit dhe në respekt të dinjitetit njerëzor.

Evakuimi, sistemimi i banorëve, të pallateve e banesave të dëmtuara, nuk varet e determinohet nga dëshira e tyre, dhe largimi i tyre *(qoftë dhe forcërisht)*, deri në rindërtimin e banesave, nuk përbën cenim të asnjë të drejte të njeriut, përkundrazi është përmbushje e detyrës ligjore dhe respektimit të së drejtave themelore të njeriut, për trajtim human e me dinjitet përsa i përket të drejtës për strehim, shëndet e siguri.

Bashkia duhej që urgjentisht, përmes Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit, të bënte largimin e përkohshëm të së moshuarës, znj. P, në një banesë tjetër *(që mund të ishte banesë sociale apo banesë tjetër e përkohshme, duke e mbështetur me bonus qiraje, etj)*, deri në rregullimin e banesës së saj. Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, Bashkia Durrës nuk ka provuar të ketë përmbushur e kryer këtë detyrë.

Në këto kushte, referuar informacionit të administruar, Bashkia Durrës, nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmarrë fillimisht për zhvendosjen e saj në një banesë tjetër përkohësisht, e mandej masat ose planin për rregullimin e banesës së znj. P, brenda dhe sipas standardeve të kërkuara teknike *(ku përfshihet edhe instalimi i rrjetit të brendshëm elektrik, kusht për furnizimin e mëvonshëm me energji elektrike)*.

Rezulton i pranuar fakti se, shtetasja M. E. P, në ambientin ku banon nuk furnizohet me energji elektrike. Minimalisht, jetesë e të moshuarës të vetmuar, në mungesë të energjisë elektrike rezulton prej vitit 2019, periudha e evidentimit të dëmeve gjatë tërmetit të vitit 2019. Bashkia Durrës, nuk e kundërshtoi pretendimin e mungesës së furnizimit me energji elektrike të banesës së znj. M. E. P dhe nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me ndonjë masë të ndërmarrë nga ana e Bashkisë për të siguruar furnizimin me energji elektrike të saj.

Komisioneri thekson gjithashtu se, drejta për energji elektrike në vetvete është një e drejtë themelore e njeriut, që buron nga e drejta për një standard të përshtatshëm jetese. Në këtë kontekst, Komisioneri nuk do të ndalet në analizimin veçmas, të situatës së mosfurnizimit me energji elektrike të banesës së znj. P, pasi kjo situatë *(mosekzistenca e rrjetit elektrik të brendshëm të banesës)* vjen si rezultat i mosndërhyrjes në rindërtimin tërësor të banesës së shkatërruar nga tërmeti i 2019-ës, dhe se do të merrte zgjidhje përfundimtare me përfundimin e punimeve në të *(në kuadër të punimeve tërësore të gjithë pallatit.)*

Bashkia Durrës nuk provoi se nga ana e saj ishin ezauruar të gjitha mjetet ligjore dhe mundësitë e tjera në dispozicion për të zgjidhur në mënyrë efektive gjendjen alarmante e kushtet tejet kritike të strehimit, të së moshuarës të vetmuar, znj. M. P, duke i rrezikuar asaj jetën dhe shëndetin.

Nga ana tjetër, Komisioneri thekson faktin se, vetë Bashkia pranon dhe konsideron rastin e znj. P, si person të një kategorie vulnerabël *(si e moshuar që jeton e vetme dhe pa përkrahjen e ndonjë të afërmi)* pasi deklaroi se e trajton atë në mënyrë të veçantë dhe me përkujdesje të shtuar, pikërisht bazuar në specifikën e situatës së saj, familjare, sociale etj.

Kjo evidentohet edhe nga marrja dhe ofrimi i shërbimeve të ndryshme sociale kundrejt znj. P si nga strukturat e Bashkisë, po ashtu dhe të Shërbimit Social Rajonal Durrës.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, Bashkia Durrës, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, të moshuarën e vetmuar, znj. M. P, përsa i takon: *së pari*, evakuimit të detyrueshëm (*në ruajtje të jetës dhe shëndetit të saj*) dhe strehimit të përkohshëm të saj, dhe *së dyti*, rindërtimit e rregullimit përfundimtar të banesës së saj me kushtet e duhura teknike, për një jetesë normale e dinjitoze.

B. Shkaku i mbrojtur “mosha” dhe “gjendja familjare”

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga pala ankuese si shkak diskriminimi, duke parashikuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në *parim*, në lidhje me shkakun e prezumuar të diskriminimit, në radhë të parë, duhet provuar se shkaku i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provohet ekzistenca e tij, nga subjekti apo pala e cenuar.

Në rastin në fjalë, prezumohet se shtetasja znj. M. P, është diskriminuar për shkak të *moshës* dhe *gjendjes familjare*.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, znj. M. E. P, posedon dy shkaqet e mbrojtura:

- të “moshës” për shkak se ajo është e moshuar, 85 -vjeçare (*e datëlindjes 26.10.1939*);
- të “gjendjes familjare”, si një person i vetmuar dhe pa asnjë familjar të gjallë, (*fakt i njohur dhe i pranuar dhe nga vetë Bashkia Durrës*) të cilët do të mund të ndihmonin apo t’i ofronin mbështetje financiare dhe emocionale, njerëzore.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet bazuar në shkaqet e: *moshës* dhe *gjendjes familjare*, të znj. M. P, pasi konsiderohen të provuara mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, me shkakun e: “moshës” dhe të “gjendjes familjare”, të znj. M. E. P.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse znj. M. P, e moshuar e cila jeton e vetmuar pa përkrahjen e asnjë familjari, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e institucionit përgjegjës respektiv, Bashkisë Durrës lidhur me lënien e saj në kushte jetese ekstreme, në një banesë të pabanueshme e cila vë në kushte reale rreziku, jetën dhe shëndetin e saj, bazuar pikërisht në shkaqet që posedon: “moshën” dhe “gjendjen familjare”, sipas shpjegimit të bërë në pjesën B, të këtij vendimi.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar. Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit/konkretisht të moshuarës të vetmuar, znj. P, lidhur me këto dy shkaqe, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

IV. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.

2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 59

Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;

b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;

c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;

ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;

d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. 33

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut¹⁰ (KEDNJ)

Neni 14

“Ndalimi i diskriminimit”

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Protokolli 12, KEDNJ

Neni 1

“Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ-së, përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Karta Social Europiane (e rishikuar), (1996), ndalon diskriminimin për një listë joshteruese shkaqesh, lidhur edhe për të drejtën për strehim. Neni E, në Pjesën V të kësaj Karte parashikon shprehimisht: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”.

¹⁰ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në pikën 25, të Komentit të Përgjithshëm Nr. 20, është shprehur se: *“Statusi i pronës, si një bazë e ndaluar e diskriminimit, është një koncept i gjerë dhe përfshin pronën e patundshme (p.sh. pronësia ose zotërimi i tokës) dhe pasuria personale (p.sh. pronësia intelektuale, mallrat dhe sendet dhe të ardhurat), ose mungesa e saj. Komiteti ka komentuar se të drejtat e Konventës, si qasja në shërbimet e ujit dhe energjisë elektrike, nuk duhet të kushtëzohen me statusin e një personi mbi pronësinë ose zotërimin e tokës, siç është jetesa në një vendbanim informal.”*

Në Nenin 11 dhe 12 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore¹¹, parashikohet detyrimi i shteteve palë për të njohur të drejtën e secilit për një standard adekuat të jetesës për vete dhe për familjen e tij, duke përfshirë ndër të tjera dhe strehimin.

Në referim të nenit 11 (1) të Paktit, shtetet palë *“njohin të drejtën e të gjithëve për një standard të përshtatshëm jetese për vete dhe familjen, duke përfshirë ushqim të përshtatshëm, veshje dhe strehim, si dhe përmirësim i vazhdueshëm të kushteve të jetesës”*.

Në përputhje me Nenin 11(1) të Komentit të Përgjithshëm Nr.4: “E drejta për strehim të Mjaftueshëm” e Komitetit Evropian për të Drejtat Ekonomike Social Kulturore (KEDS), strehimi i përshtatshëm duhet të plotësojë një sërë kriteresh, dhe në veçanti duhet:

- të jetë me cilësi të mjaftueshme për garantimin e mbrojtjes nga elementët,
- duhet të reflektojë kriteret kulturore të banorëve
- të jetë e lidhur me shërbimet e ujësjellës kanalizimeve,
- si dhe të jetë e lidhur me shërbimet publike nëpërmjet një infrastrukture të përshtatshme.

Referuar rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010, në të cilën Asambleja njohu të drejtën për strehim si një të drejtë të njeriut, e cila është thelbësore për gëzimin e plotë të jetës dhe të të gjitha të drejtave të njeriut, theksohet se strehimi është esencial në realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut.

Sipas nenit 7, të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore, nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe të drejtës për strehim të përshtatshëm sipas nenit 11, të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Social Kulturore, pavarësisht se nuk jepet një përkufizim të termit “strehim”, sugjerohet që, sugjerohet që dispozitat e mësipërme duhet të interpretohen në dritën e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, në veçanti të drejtës për respektimin e shtëpisë.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë¹², Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: *“.....kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme.....”*.

¹¹Aderuar me ligjin nr. 7511/1991 “Për aderimin në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”

¹²Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

Në interpretim të çështjes së sipërcituar, GJEDNJ përcakton se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm¹³ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

Ligji nr. 121/2016 *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*, ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Ky Ligj, thekson rëndësinë e shërbimeve komunitare për të përmbushur nevojat e anëtarëve të komunitetit, me karakteristika të veçanta, që i bën ata më vulnerabël në raport me qytetarët e tjerë.

Ligji nr. 121/2016, *“Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”*, ka përcaktuar rolin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (neni 31) si përgjegjëse për përcaktimin e politikave, standardeve minimale të shërbimeve, kriterëve dhe kushteve që duhet të përmbushin subjektet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, këshillimin dhe udhëzimin e bashkive për planifikimin e shërbimeve dhe strukturat përgjegjëse, si dhe planifikimin e nevojave për financim të shërbimeve nga buxheti i shtetit.

Standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror frymëzohen nga parimet themelore që përshkojnë kujdesin shoqëror, siç janë: parimi i garantimit të vlerave dhe personalitetit të individit; universaliteti; barazia e mundësive; e drejta për të përfutur; partneriteti; transparenca dhe paanshmëria; mosdiskriminimi; decentralizimi; pavarësia; integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit.

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Shërbime të kujdesit shoqëror” është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

“Shërbime rezidenciale” janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike.

Llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në këtë Ligj, ndër të tjera, janë:

“...shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuara të përfituesve.

¹³ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

...Shërbimet e kujdesit shoqëror janë shërbime rezidenciale kur është i pashmangshëm dhe i papërshtatshëm ofrimi i tyre në familje apo komunitet.

...Në shërbimet shoqërore publike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.”

Neni 21, i këtij Ligji, Shërbimet në qendrat rezidenciale, parashikon se:

1. Shërbime në qendrat rezidenciale konsiderohen shërbimet e strehimit afatgjatë dhe të organizuar që u ofrohet kategorive në nevojë, për të cilat kujdesi në shtëpi nuk është i mundur.
2. Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të individit.

Neni 22, Strehimi afatgjatë

1. Strehimi afatgjatë u sigurohet individëve që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore, kur ky kujdes nuk u sigurohet dot në familje apo familje kujdestare.
2. Personat që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm janë:
 - a)....
 - b) të moshuarit dhe të sëmurët rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore.

Ligji 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ngarkoi njësitë e pushtetit vendor me një gamë të gjerë përgjegjësish dhe funksionesh të reja, përfshirë ato në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror që lidhen me identifikimin, vlerësimin dhe planifikimin e masave për plotësimin e nevojave të komunitetit, në përgjithësi dhe grupeve në nevojë, në veçanti.

Nenet 3, 9, 23 dhe 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në mënyrë të përmbledhur parashikojnë se vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë, si dhe realizimit të shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara në ligj ose akte të tjera normative, nëpërmjet mirëmbajtjes së rrugëve vendore, mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane, si dhe përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm, krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, strehimin e tyre, etj.

Komisioneri vëren se, *drejta për energji elektrike* nuk është thjesht një shërbim. E drejta për energji elektrike në vetvete është një e drejtë themelore e njeriut, që buron nga e drejta për një standard të përshtatshëm jetese. Një nga referencat e para për të është në nenin 25 (1) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i konsideruar gjerësisht si instrumenti kryesor për mbrojtjen e të drejtës për strehim të përshtatshëm, i referohet të drejtës së secilit për një standard të duhur jetese për vete dhe familjen e tij, përfshirë ushqimin, veshjen e përshtatshme dhe strehimin, dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës (neni 11).

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ka theksuar se, e drejta për strehim të përshtatshëm nuk duhet të interpretohet ngushtë. Përkundrazi, duhet parë si një e drejtë për të jetuar në siguri, paqe dhe dinjitet. Karakteristikat e së drejtës për strehim të përshtatshëm sqarohen kryesisht në Komentin e Përgjithshëm nr.4 (1991) mbi të drejtën për strehim të përshtatshëm, të këtij komiteti. Strehimi i përshtatshëm, duhet të sigurojë më shumë se katër mure dhe një çati. Duhet të plotësohen një numër kushtesh të veçanta të strehimit, që të mund të flasim për "strehim të përshtatshëm". Sipas këtyre kriterëve, strehimi nuk është i përshtatshëm, nëse banorët e tij nuk kanë ujë të pijshëm të sigurt, kanalizime të përshtatshme, energji për gatim, ngrohje, ndriçim, ruajtjen e ushqimit ose hedhjen e mbeturinave.

Të drejtat e njeriut janë të ndërruar, të pandashme dhe të ndërlidhura. Me fjalë të tjera, shkelja e të drejtës për strehim të përshtatshëm mund të ndikojë në gëzimin e shumë të drejtave të tjera të njeriut dhe anasjelltas. Qasja në strehim të përshtatshëm mund të jetë parakusht për gëzimin e disa të drejtave të njeriut.

Energjia elektrike është një komponent kryesor dhe thelbësor i strehimit të përshtatshëm, prandaj të jetosh në ditët e sotme pa energji elektrike e bën jetën e secilit të vështirë ose ekstremisht të pamundur. Qasja ndaj energjisë elektrike është një parakusht i pashmangshëm për një strehim të përshtatshëm dhe njëkohësisht është thelbësor për garantimin e të drejtave të tjera, duke siguruar gjithashtu uljen e varfërisë. Mungesa e qasjes ndaj energjisë elektrike është njëkohësisht pasojë e varfërisë, por edhe një nga shkaktarët e saj.

Në kuadër të Këshillit të Evropës, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Karta Sociale Europiane nuk i referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtës për energji elektrike, por në jurisprudencën e GJEDNJ, mbrojtja e saj ka ardhur si rezultat i gëzimit të të drejtave të tjera të njeriut. Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut në rastin *Pocasovschi dhe Mihaila kundër Republikës së Moldavisë dhe Rusisë* (Kërkesa nr.1089/09) ka vendosur që mungesa e energjisë elektrike, është shkelje e të drejtave të njeriut, pikërisht të neneve 3 dhe 8 të Konventës, duke e konsideruar atë në kushtet e trajtimit çnjerëzor.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Neni 1

“Objekti”

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e

seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër

Neni 2

“Qëllimi”

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3, “Përkufizimet”

“*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Strehimi është një shërbim, që ofrohet nga institucionet përgjegjëse në fushën e shërbimeve, ndaj në këtë kontekst ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili ofron mbrojtje të posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve, parashikon shprehimisht në nenin 20, të tij.

Neni 20

“Të mirat dhe shërbimet”

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.
2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

Neni 22

“Statusi”

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

“Kompetencat”

1.Komisioneri ka kompetencë:

...c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

...ë) t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030¹⁴, ka parashikuar se:

“Dokumenti Politik për Moshimin 2020-2024¹⁵, që parashikon që shërbimet sociale për të moshuarit realizohen nëpërmjet Shërbimeve të kujdesit shoqëror, që ofrohen në qendrat publike të shërbimeve si; qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose shërbime në shtëpi dhe financohen nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore si dhe shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendra jopublike, nga organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse.”

Strategjia parashikon dhe përgjegjësitë e Njësive të Qeverisjes Vendore. Sipas Reformës Territoriale të miratuar nëpërmjet ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë dhe bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, sigurimi dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë të moshuarit, është përgjegjësi e njësive të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht për:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal;
- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore;
- Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në nivel vendor kanë përgjegjësi për planifikimin, administrimin dhe ofrimin e asistencës sociale dhe shërbimeve sociale në nivel lokal. Njësitë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN), Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve (NJMF), koordinatorët lokal përgjegjës për dhunën në familje dhe ndaj grave dhe punonjës të tjerë të shërbimeve sociale janë përgjegjës për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal, ndërtimin dhe administrimin e qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore si dhe krijimin e shërbimeve dhe tipologjive të ndryshme të shërbimit për t’iu përgjigjur nevojave të grupeve të ndryshme në kontekstin lokal.

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 864, datë 24.12.2019 “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”, ka vendosur:

¹⁴ Final Draft

¹⁵ <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/vendim-2019-12-24-864.pdf>

“1. Miratimin e dokumentit politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e varësisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi”.

Plani Kombëtar i Veprimit mbi Moshimin, 2020-2024¹⁶, citon ndër të tjera, se:

“... është një përgjigje ndaj sfidës demografike dhe sociale të moshimit në një periudhë transformimi demografik të pavërejtur kurrë më parë në historinë e Shqipërisë, periudhë gjatë së cilës numri i personave të moshuar është rritur me disa herë, ndërkohë që ka rënë numri i fëmijëve, si pasojë e rënies së fertilitetit, si dhe numrit të të rinjve, për shkak të emigracionit. Ka gjithnjë e më shumë persona që mund dhe duhet të vijojnë të marrin pjesë aktive në shoqëri edhe gjatë moshës së pensionit. Nga ana tjetër, tranzicioni i përshpejtuar demografik është shoqëruar nga një zvogëlim i familjes dhe i rolit të saj tradicional mbështetës për të moshuarit me nevoja të veçanta. Për më tepër, ndryshe nga shumica e vendeve të rajonit, Shqipëria nuk trashëgon nga e kaluara një sistem tradicional e të integruar të kujdesit shëndetësor e social për të moshuarit.

Dokumenti Politik ka për qëllim mbështetjen e një integrimi më të mirë të të moshuarve në shoqëri, shërbime me cilësi për të gjithë, si dhe një jetë të gjatë, të shëndetshme dhe produktive për ta.

Plani mbi Moshimin është në linjë me konkluzionet e Bashkimit European “Moshim i shëndetshëm gjatë gjithë ciklit të jetës”, ndërkohë që Programi i Tretë Shëndetësor i BE-së identifikon ndryshimet demografike si një sfidë kyç për rajonin tonë.

Nëpërmjet zbatimit të këtij Plani, qeveria shqiptare synon të arrijë sigurimin e rritjes me një vit shtesë të jetëgjatësisë së shëndetshme në Shqipëri, përgjysmimin e varfërisë te personat mbi 65 vjeç dhe mbulimin e plotë me shërbime shëndetësore dhe sociale për të moshuarit që kanë nevojë për to.

Gjatë zbatimit të këtij Plani do të arrijmë të përmirësojmë pensionet dhe aksesin në transportin publik për mijëra të moshuar vulnerabël. Mijëra të moshuar të tjerë do të mund të përfitojnë nga qendrat e reja ditore dhe aktivitetet sociale të organizuara nga qeveria dhe bashkitë, ndërkohë që do të ketë më shumë mundësi për strehim dhe qendra rezidenciale për ata që janë me nevoja të veçanta. Gjithashtu, çdo vit, dhjetëra e mijëra të moshuar do të kenë mundësi të reja për shërbime sociale dhe shëndetësore të integruara dhe me cilësi më të lartë.”

Qëllimi i përbashkët i këtyre akteve ligjore dhe nënligjore është që nëpërmjet tyre të mbrohet dhe të sigurohet që, të gjithë personat e moshuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

¹⁶ Miratuar me VKM nr. 864, datë 24.12.2019 “Për miratimin e dokumentit politik kombëtar moshimin, 2020-2024he të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”.

Këshilli i Ministrave ka miratuar paketën e plotë ligjore për t'i paraprirë situatës së vonesave të mundshme gjatë procedurave administrative të rindërtimit, si në rastin konkret të miratimit të fondit për rihotimin e ndërtesës ku banon e moshuara e vetmuar, znj. P. Sakaq, përmes miratimit të akteve normative të sipërcituara, Këshilli i Ministrave, për të mos vënë në rrezik jetën e banorëve të cilët jetojnë në ndërtesa të dëmtuara, i ka dhënë banorëve, mundësinë për të gjetur një banesë tjetër në tregun e lirë, për të cilën organet e njësive të vetëqeverisjes vendore deri në përfundimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të banesës, ti rimburojnë qiranë në vlerën mesatare të tregut të lirë.

Në këtë kuptim, duke marrë në konsideratë situatën e jashtëzakonshme të krijuar si rezultat i fatkeqësisë natyrore, tërmetit që goditi Shqipërinë në datën 26 Nëntor 2019, Komisioneri gjykon se qeveria i ka ofruar alternativa banorëve të prekur, për t'u strehuar në banesa sociale apo banesa me qira, që do të mbulohen nga strukturat përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore deri në momentin e rikonstruksionit të banesave.

Nga analiza e provave të administruara dhe informacionit të parashtruar nga ana e Bashkisë Durrës rezulton se në qytetin e Durrësit janë 8 (tetë) njësi banimi ndërtesa (pallat), të cilat ndodhen në të njëjtat kushte. Pra, veç ndërtesës (pallatit me kod Gis 19063)), ku banon znj. P, janë dhe 7 ndërtesa (pallate) të tjera me nivel dëmi DS4.

E drejta për strehim të përshtatshëm, (ku përfshihet e drejta për të patur energji elektrike), është një e drejtë themelore e njeriut. Si e tillë, shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë akses në energji elektrike, e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e një strehimi të papërshtatshëm.

Në rastin konkret, Bashkia Durrës, si njësi e vetëqeverisjes vendore në fushën e kompetencës të të cilës përfshihen çështjet e strehimit dhe si njësia e vetëqeverisjes vendore në juridiksionin e të cilës është banore *de facto*, e moshuara e vetmuar, znj. M. E. P, ka detyrimin për të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme për të siguruar që kjo shtetase, banore e qytetit të Durrësit, të gëzojë në mënyrë efektive kushte të përshtatshme strehimi, ku përfshihet edhe e drejta për t'u furnizuar me energji elektrike.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit rregullohet nga neni neni 33, pika 7/1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Sa më sipër, lidhur me rastin e të moshuarës të vetmuar, znj. P, mjafton që të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), dhe barra e provës më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin¹⁷

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë *trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet*. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ose po shqyrtohet çështja, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, *duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim*.

Në aspektin procedural, si fillim duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtuara në këtë çështje.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, Bashkia Durrës, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, të moshuarën e vetmuar, znj. P, përse i takon: *së pari*, mos evakuimit të detyrueshëm (*në ruajtje të jetës dhe shëndetit të saj*) dhe strehimit të përkohshëm të saj, dhe *së dyti*, rregullimit përfundimtar të banesës së saj me kushtet e duhura teknike, për një jetesë normale e dinjitoze.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (diskriminimi *prima facie*) se në pamje të parë e moshuara e vetmuar, znj. M. P, është diskriminuar për shkak të *moshës* dhe të *gjendjes familjare*, në të drejtën për një strehim të përshtatshëm e të sigurtë.

Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Bashkisë Durrës, i kalon barra e provës për të provuar se, trajtimi të cilit i është nënshtruar znj. P, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Të drejtat dhe liritë duhet të garantohen jo vetëm *de jure*, por edhe *de facto*, pra të sigurohet gëzimi në mënyrë efektive nga ana e personave.

Komisioneri vlerëson se, është në detyrimin e njësisë së vetëqeverisjes vendose, në rastin konkret

¹⁷ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232

Bashkisë Durrës, që të sigurojë duke marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme që, e moshuara e vetmuar, znj. P, si pasojë e dëmtimit të rëndë të banesës së saj nga tërmeti i vitit 2019, të jetojë në një banesë tjetër të përkohshme (*të ndryshme nga ajo aktualja*) të sigurtë dhe me kushte të përshtatshme banimi, deri në përfundim të rindërtimit të plotë me parametrat e duhura e të nevojshme teknike, për t'i garantuar asaj një jetësë të përshtatshme, normale e dinjitoze.

Në bazë të fakteve dhe provave të administruara, Komisioneri vlerëson se në mënyrë të pajustificuar dhe për një kohëzgjatje të konsiderueshme 5 vjeçare, Bashkia Durrës nuk ka ndërmarrë asnjë përpjekje për të bërë të përmushur sa më sipër, për më tepër duke ditur moshën dhe natyrën specifike sociale e familjare të saj (*në kushtet kur është në detyrimin e saj si njësi e vetëqeverisjes vendore që të jetë në dijeni të situatës së znj. P*), si person në nevojë emergjente për t'u evakuar nga banesa e dëmtuar dhe strehuar në mënyrë të përkoshme nga ana e kësaj Bashkie.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara në lidhje me rastin e të moshuarës të vetmuar, znj. P, Komisioneri vlerëson se Bashkia Durrës nuk arriti që të jepte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, se trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm karshi saj, nuk ka ardhur si pasojë e shkaqeve të cituara.

Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Durrës, nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmarrë fillimisht për zhvendosjen e znj. P, në një banesë tjetër përkohësisht, si dhe për masat ose planin për rregullimin e banesës të së moshuarës, brenda dhe sipas standardeve të kërkuara teknike, ku përfshihet edhe instalimi i rrjetit të brendshëm elektrik, duke e diskriminuar atë, në të drejtën për strehim të përshtatshëm, për shkak të *moshës dhe gjendjes familjare* të saj.

Komisioneri konsideron si rrethanë rënduese mbi Bashkinë, edhe:

- faktin se ajo i njihte e pranonte këto shkaqe, cilësitë si e *moshuar e vetmuar dhe pa përkrahjen e ndonjë familjari*, pasi pikërisht për shkak të këtyre cilësive ajo, e konsideronte të moshuarën si pjesë e një kategorie më vulnerabël se të moshuarit e tjerë (*që kanë të afërm e familjarë që i mbështesin ata*), dhe për këtë arsye deklaroi se e trajton me një kujdes të shtuar;
- faktin që ajo nuk ndërmori asnjë masë paraprake për zgjidhje *emergjente*, të përkohshme të situatës kritike në të cilën ndodhej e moshuara e vetmuar, në kushtet e të ftohtit ekstrem të dimrit, duke lënë të banojë në një banesë pa dyer e dritare, pa energji, pa ndriçim dhe ngrohje, një zonjë të moshës 85 vjeçare;
- faktin se e ka vënë të moshuarën në kushtet e një rrishtu real, konkret dhe evident të jetës dhe të shëndetit të saj;
- faktin se (*pavarësisht se i ishte kërkuar specifikisht nga Komisioneri*) ka neglizhuar marrjen e masave *emergjente*, konkrete, të përkohshme deri në zgjidhjen përfundimtare të sigurimit të banesës së saj në kushte të përshtatshme e dinjitoze;
- si dhe mungesën e empatisë dhe detyrimit human, përveç detyrimeve ligjore të evidentuara gjatë analizës së mësipërme në vendim.

Për rrjedhojë Bashkia Durrës, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, të parashikuar nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, garanton mbrojtje të drejtëpërdrejtë nga diskriminimi dhe ndalon diferencat në trajtim, për shkak të *moshës* dhe *gjendjes familjare*.

Bazuar në faktet dhe situatën e analizuar më sipër, kryesisht Komisioneri konstaton se, situata e analizuar është pasojë jo vetëm e *moshës* dhe *gjendjes familjare*, (si person i vetmuar pa asnjë familjar apo të afërm) të trajtuara veçmas, por është rrjedhojë e ndërveprimit të këtyre dy shkaqeve, ku të dy shkaqet bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme me njëri-tjetri, duke sjellë pasoja veçanërisht të rënda për sigurinë e jetës, shëndetin dhe cilësinë e jetesës së znj. P.

“Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.¹⁸”

Gjithashtu, bazuar në nenin 3/1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit”, konsiderohet si formë e rëndë diskriminimi. Kjo dispozitë, nuk kërkon që të plotësohen në mënyrë kumulative të gjithë elementët, në lidhje me shkakun, recidivizmin, kohëzgjatjen dhe pasojat e sjelljes diskriminuese. Forma e rëndë e diskriminimit konstatohet me përmbushjen qoftë edhe të vetëm njërit prej elementëve të përcaktuar në këtë dispozitë ligjore.

Komisioneri, vlerëson se shkakun i *moshës* dhe *gjendjes familjare*, veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme me njëri-tjetrin, duke e ekspozuar të moshuarën e vetmuar, znj. P ndaj trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë.

Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Durrës, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka diskriminuar për shkak të *moshës* dhe *gjendjes familjare*, znj. P, lidhur me mosmarrjen e masave për sigurimin e një strehimi të sigurtë të saj.

Barazia dhe mosdiskriminimi imponojnë jo vetëm ndalimin e diferencës në trajtim, por edhe detyrimin për të adresuar ndryshe nevojat e veçanta që kanë grupe të ndryshme të cilët janë më shumë të cenueshëm ose vulnerabël. Dështimi për të përmbushur detyrimet e mësipërme, përbën diskriminim.

¹⁸ Neni 3, pika 3, e LMD-së.

Komisioneri, thekson faktin se, pavarësisht se nuk ka qenë qëllimi i Bashkisë, që të vendosin në pozita të pafavorshme dhe të padrejta të moshuarën e vetmuar, znj. P, mungesa e tij, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia, në kushtet kur provohet se ky institucion përgjegjës, nuk ka arritur që të shmangë pasojat, duke bërë që asaj t'i cenohet e drejta për jëtë, shëndetin, si dhe një banesë të përshtatshme e dinjtoze.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson si masë emergjente për rregullimin e situatës, për të moshuarën e vetmuar, znj. M. E. P, marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Durrës, si institucioni përgjegjës, për përmbushjen e detyrimit të saj për avakuimin e menjëhershëm nga banesa aktuale dhe strehim të përkohshëm të saj deri në rindërtimin e banesës së saj të dëmtuar rëndë nga tërmeti i vitit 2019, me të gjithë parametrat e nevojshme teknik, për një jetesë të përshtatshme e dinjtoze.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, në formën e rëndë të tij dhe në formën e diskriminimit ndërsektorial, për shkak të “moshës” dhe “gjendjes familjare”, të znj. M. E. P, nga ana e Bashkisë Durrës.
2. Referuar pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga e Bashkisë Durrës, për evakuimin nga banesa aktuale dhe strehim të përkohshëm të znj. M. E. P, deri në rindërtimin përfundimtar të banesës së saj me të gjithë parametrat e duhur teknik.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Durrës brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA